

## **KLEVIS XHOXHI**



**Datëlindja:** 30.11.1978

**Vendlindja:** Elbasan

**Email:** Klevis.Xhoxhi@parlament.al/

### **Jetëshkrimi:**

Z. Klevis Xhoxhi ka përfunduar studimet e larta për juridik në vitin 2001 dhe më vonë në vitin 2011 ka përfunduar masterin e nivelit të dytë në Shkenca Politike për degën Administrim Publik.

Ai ka marrë titullin avokat në vitin 2006.

Gjatë viteve 20013-20016, ai ka punuar si jurist në Prefekturën e Qarkut Elbasan. Ai ka një përvojë të gjatë si drejtues në disa drejtori dhe institucione.

Në 2006-2007 është emëruar drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Automjeteve SHA, në 2007-2008 emërohet drejton Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë Elbasan, në 2008-2015 ka qenë drejtor i Qendrës Ekonomike të Arsimit Elbasan dhe në 2019-2020 drejtor i Drejtorisë Vendore Elbasan në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Z. Klevis Xhoxhi ka mbajtur postet e Zëvendëskryetarit të Bashkisë Elbasan për periudhën 2015-2019 dhe për një periudhë të shkurtër kohore atë të Prefektit të Qarkut Elbasan, tetor 2020-mars 2021.

Z. Xhoxhi ka kryer një sërë trajnimesh kualifikuese mbi Legjislacionin Ndërkombëtar mbi Politikën Mjedisore të BE-së, Për Drejtim të Zhvillimit të Qendrueshëm ndaj Sfidave Politike dhe Qeveritare të BE-së dhe është Ekspert në Proceset e Prokurimeve Publike.

Gjithashtu, ai ka marrë pjesë në “International Summer school Albania driving sustainable Development Towards the EU changes”.

Z. Xhoxhi është mandatar për herë të parë si deputet i Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjet parlamentare të 2021.